

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Valdete Daka, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarve: Sh.C, L.B, L.S, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vjedhja grabitqare, nga neni 328 par.4 të KPRK-së, L.S dhe L.B, për shkak të veprës penale secili veç e veç mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPRK-së dhe të dënuarit A.R, për shkak të ndihmës në kryerjen e veprës penale vjedhja grabitqare nga neni 328 par.4 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga i dënuari Sh.C dhe mbrojtësit e të dënuarve: Sh.C, av. N.S, L.B, av. R.K dhe L.S, av. N.H, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.125/2016 të datës 29.11.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.90/2018 të datës 03.05.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 18 dhjetor 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si e pabazuara kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë e të dënuarit Sh.C dhe mbrojtësve të të dënuarve Sh.C, L.B dhe L.S, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.125/2016 të datës 29.11.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.90/2018 të datës 03.05.2018.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.125/2016 e datës 29.11.2017, të dënuarit: Sh.C, L.B dhe L.S, i ka shpallur fajtor për

veprën penale në bashkëkryerje vjedhja grabitqare, nga neni 328 par.4 të KPRK-së, kurse të dënuarit L.B dhe L.S, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPRK-së si dhe të dënuarin A.R, për shkak të ndihmës në kryerjen e veprës penale vjedhja grabitqare, nga neni 328 par.4 të KPRK-së dhe i ka gjykuar: të dënuarin Sh.C me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 08.04.2015 e tutje, të dënuarin L.B me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 17 (shtatëmbëdhjetë) vite e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 10.04.2015 e tutje, të dënuarin L.S me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 20 (njëzetë) vite e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 10.04.2015 e tutje, kurse të dënuarin A.R me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite e 10 (dhjetë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 08.04.2015 deri më datë 10.07.2017. Janë obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej nga 300 €, kurse e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.90/2018 e datës 03.05.2018, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe mbrojtësve të të dënuarve dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, kurse ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar e ka hudhur si të palejuar.

Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë paraqitur:

- i dënuari Sh.C, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen ta kthej në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë;

- mbrojtësi i të dënuarit Sh.C, av. N.S., për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të anuloj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, kurse aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta ndryshoj ashtu që të bëj ricilësimin e veprës penale nga bashkëkryerje në veprën penale të vjedhjes grabitqare, nga neni 328 par.4 të KPRK-së në veprën penale të ndihmës në kryerjen e veprës penale të vjedhjes grabitqare, nga neni 33 par.2 i KPRK-së;

- mbrojtësi i të dënuarit L.B, av. R.K, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen ta kthej në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë;

- mbrojtësi i të dënuarit L.S, av. N.H, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen ta kthej në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.230/2018 e datës 03.12.2018, ka propozuar që kërkesat e të dënuarit Sh.C dhe e mbrojtësve të të dënuarve, të refuzohet si të pabazuara.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë i dënuari Sh.C, thekson se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje të dispozitave të procedurës penale të përcaktuar me dispozitën e nenit 384 par.8 dhe 12 të KPPK-së, sepse dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i pakuptueshëm dhe kundërthënës në brendinë e tij. Nuk është paraqitur arsyetim përkitazi me faktet vendimtare dhe ka kundërthënie mes arsyetimit dhe shkresave të çështjes, ashtu që aktgjykimi nuk është përpiluar

konform dispozitës së nenit 370 të KPPK-së. Dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i paqartë, konfuz dhe i pakuptueshëm dhe nuk ka mbështetje në provat e administruara. Për më tepër nuk përmendet asnjë veprim konkret i të dënuarit Sh.C përkitazi me kontributin e tij në kryerjen e kësaj vepre penale përkatësisht vrasjes së tani të ndjerit.

Pretendohet se gjykata e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë e marrin si fakt të pakontestueshëm vetëm marrëveshjen e të dënuarve për të vjedhur dhe për ndarjen e të hollave në pjesë të barabarta, mirëpo asnjë herë të dënuarit nuk kanë biseduar përkitazi me faktin se nëse hasin në ndonjë person ta vrasin atë përkatësisht vrasja e të ndjerit nuk ishte pjesë e marrëveshjes dhe me këtë edhe nuk është realizuar bashkëkryerja. Për realizimin e bashkëkryerjes të secili pjesëmarrës duhet të ekzistoj dashja për të kryer atë vepër penale dhe duhet të pajtohen me pasojën e veprimit të shkaktuar dhe jo si në rastin konkret ku i dënuari Sh.C nuk ka qenë prezent kur është kryer vepra penale. Më tutje në kërkesë pretendohet se dhënia e direktivave për vjedhje si në rastin konkret nuk mund të konsiderohet bashkëkryerje pa ndërmarrë asnjë veprim konkret, pasi që bashkëkryerja është pjesëmarrje e vullnetshme dhe e vetëdijshme për realizimin e një qëllimi dhe ky qëllim ka qenë vjedhja e kasafortës me para dhe jo vrasja e të ndjerit.

Në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë nuk është bërë analizë e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë e as pretendimeve ankimore të mbrojtësve të të dënuarve, mirëpo vetëm është përshkruar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nga rreshti në rresht dhe nga faqja në faqe.

Mbrojtësi i të dënuarit Sh.C, av. N.S, në kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë thekson se në veprimet e të dënuarit ekzistojnë elementet e veprës penale të ndihmës, nga neni 33 i KPRK-së, duke pasur parasysh se edhe ndihma është formë e bashkëpunimit, por forma më e lehtë se saj dhe se veprimet e të dënuarit siç janë përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit i përgjigjen veprimeve të ndihmës pasi që i dënuari Sh.C, u kishte dhënë udhëzime dhe informata të mjaftueshme të dënuarve të tjerë për të kryer veprën penale të vjedhjes. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përkitazi me të dënuarin Sh.C është bazuar në deklaratimet e të dënuarve të tjerë dhe deklaratimin vet akuzues të të dënuarit e që del se me këtë rast është vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 384 par.1 nënpar.1.12 të KPPK-së, pasi që provat e tilla nuk janë prova të pranueshme.

Pretendohet se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i pakuptueshëm, jo i thuktë dhe jo përmbajtësor dhe në kundërshtim me vet veten, përkitazi me kohën e kryerjes së veprës penale e me këtë dispozitivin e aktgjykimit e bëjnë të pakuptueshëm.

Më tutje pretendohet për shkeljen e ligjit penal përkatësisht vendimit mbi dënimin dhe se me këtë rast gjykata e shkallës së parë ka shkelur kompetencat ligjore pasi që ka shqiptuar dënim për një veprë penale e cila nuk është kryer nga i dënuari. Gjykata e shkallës së parë në rastin konkret ka qenë dashur ta ndryshoj cilësimin juridik pasi që në veprimet e tij janë manifestuar elementet e ndihmës në kryerjen e kësaj veprë penale dhe jo të bashkëkryerjes për të cilën i dënuari është shpallur fajtor. Megjithatë edhe nëse do të ekzistonte vepra penale për të cilën i dënuari Sh.C është shpallur fajtor megjithatë dënimi i shqiptuar është shumë i lartë dhe nuk është në përputhje me shkallën dhe intensitetin e veprimeve të tij dhe përmes këtij dënimi nuk arrihet qëllimi i dënimit. Me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë çmuar rrethanat se i dënuari Sh.C ka qenë me moshë më të re nga të dënuarit e tjerë dhe se ishte manipuluar nga ta për kryerjen e veprës penale, ashtu që me rastin e shqiptimit të dënimit janë mbivlerësuar rrethanat rënduese dhe nënvlerësuar rrethanat e shumta lehtësuese, moshë e tij e re, se të dy prindërit i kishte humbur në aksident, se më parë nuk kishte rënë ndesh me ligjin si dhe pendimin e tij për veprën e kryer.

Mbrojtësi i të dënuarit L.B, av. R.K., në kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë thekson se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje të dispozitave të procedurës penale të përcaktuar me dispozitën e nenit 384 par.8 dhe 12 të KPPK-së, sepse dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij dhe nuk janë paraqitur arsyet për faktet vendimtare dhe ka kundërthënë mes të arsyetimit dhe shkresave të çështjes, ashtu që aktgjykimi nuk është përpiluar konform dispozitës së nenit 370 të KPPK-së.

Dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i paqartë, pasi që bazuar në dispozitën e nenit 370 par.4 të KPPK-së, në rastet kur i dënuari shpallet fajtor në dispozitiv duhet të theksohen faktet dhe rrethanat që e përbëjnë figurën e veprës penale nga të cilat varet zbatimi i dispozitës materiale, ashtu që dispozitivin e aktgjykimit e bën të paqartë, konfuz dhe të pakuptueshëm, për më tepër nuk ka mbështetje në provat e administruara. Theksohet se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk përmend asnjë veprim të të dënuarit L.B, përmes të cilit veprim ka kontribuar në vrasjen e tani të ndjerit dhe me këtë nuk është vërtetuar as kryerja

e kësaj vepre penale. Edhe në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë nuk është bërë analizë e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë e as pretendimeve ankimore të mbrojtësve të të dënuarve, mirëpo vetëm është përshkruar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë e marrin si fakt të pakontestueshëm vetëm marrëveshjen e të dënuarve për të vjedhur dhe për ndarjen e të hollave në pjesë të barabarta, mirëpo të dënuarit asnjëherë nuk kanë biseduar përkitazi me faktin se nëse hasin në ndonjë person ta vrasin atë përkatësisht vrasja e të ndjerit nuk ishte pjesë e marrëveshjes dhe me këtë edhe nuk është realizuar bashkëkryerja. Për realizimin e bashkëkryerjes te secili pjesëmarrës duhet të ekzistoj dashja për të kryer atë vepër penale dhe duhet të pajtohen me pasojën e veprimit të shkaktuar dhe jo si në rastin konkret ku i dënuari L.B nuk ka marrë asnjë veprim konkret që ta privon nga jeta tani të ndjerin.

Më tutje pretendohet se në veprimet e të dënuarit nuk ekzistojnë elementet e veprës penale të bashkëkryerjes e kjo theksohet edhe në vet arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë ku theksohet se i dënuari ka qenë prezent me L.S, në momentin e planifikimit të vjedhjes dhe në momentin e vjedhjes, kurse gjykata e thekson se ka qenë prezent edhe në momentin kur L.S, ka shtënë me armë në viktimën. Andaj, prezenca e të dënuarit L.B në momentin e shtënjes me armë nuk e bën bashkëkryes të veprës penale pasi që bashkëkryerja definohet si pjesëmarrje e vullnetshme dhe e vetëdijshme në realizimin e qëllimit kurse qëllimi ka qenë vjedhja e arkës me para dhe nga kjo rrjedh se te bashkëkryerja secili duhet të përgjigjet për veprimet e veta dhe askush nuk përgjigjet për veprimet e tjetrit.

Mbrojtësi i të dënuarit L.S, av. N.H, në kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë thekson se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje të shumta të dispozitave të procedurës penale siç janë theksuar edhe me rastin e parashtrimin të ankesës në gjykatën e shkallës së dytë. Pretendohet se pasi që në rastin konkret i dënuari është i moshës relativisht të re ka qenë dashur që të pranohet propozimi i bërë para shqyrtimit fillestar dhe ndaj të dënuarit të bëhej ekzaminimi mjekësor psikiatrik dhe me këtë rast duhej që rasti të gjykohej nga departamenti për të mitur dhe jo për krime të rënda, sipas mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës. Gjykata e shkallës së parë e as gjykata e shkallës së dytë, nuk ka marrë për bazë propozimin për ekzaminimin me mjete të sofistikuara të video incizimeve me qëllim që të vërtetohet mjete i evidentuar me numër të provës

V#5 që ka pasur në dorë tani i ndjeri pasi që përmes incizimeve nuk ishte parë mirë mjete që kishte në dorë i ndjeri edhe pse është evidente se i dënuari kishte pësuar tri plagë - lëndime me thikë e i cili ekzaminimin do të ndikonte në zgjidhjen e drejtë të kësaj çështje. Në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë nuk është arsyetuar mos aprovimi i propozimit për dëgjimin e ekspertit Dr. F.D., edhe pse do të hiqte dilemat e lëndimeve të pësuar nga i dënuari L.S.

Në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë me asnjë provë nuk ka vërtetuar se me të shtënë e parë është goditur i dëmtuari dhe po ashtu nuk është konstatuar se plagët i ka marrë para se të vie deri te kontakti fizik mes të dënuarit dhe viktimës. Me këtë rast nuk është arritur që procedura të zhvillohet në pajtim me dispozitat e procedurës penale dhe për këtë arsye edhe kualifikimi ligjor dhe veprimet e të dënuarit nuk vërtetojnë se i dënuari ka pasur për qëllim që ta privon nga jeta të ndjerin dhe me këtë nuk janë vërtetuar elementet e veprës penale vjedhja grabitqare.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

kërkesat e paraqitura nga i dënuari Sh.C dhe mbrojtësit e të dënuarve Sh.C, L.B dhe L.S nuk janë të bazuara.

Nuk janë të bazuara pretendimet e paraqitura në kërkesën e të dënuarit Sh.C dhe të mbrojtësit të tij se aktgjykimi i shkallës së parë dhe aktgjykimi i shkallës së dytë, janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë është i kuptueshëm dhe nuk ka kundërthënie për faktet vendimtare, pasi që është përpiluar në tërësi sipas dispozitës së nenit 370 të KPPK-së.

Dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë përkitazi me të dënuarin Sh.C është i qartë dhe i kuptueshëm dhe nuk ka as edhe një kundërthënie në brendinë e tij, përkundrazi janë përshkruar të gjitha veprimet konkrete të të dënuarit Sh.C që në tërësinë e ngjarjes përmbajnë

aspekte të bashkëkryerjes në veprën penale të vjedhjes grabitqare nga neni 328 par.4 të KPRK-së. Në dispozitiv të aktgjykimit qartazi është shënuar se në rastin konkret i dënuari Sh.C u ka dhënë instruksione dy të dënuarve tjerë (L.B dhe L.S), përkatësisht duke i informuar për vendin ku gjendej sefi i të hollave në kafitrinë “D..C..”, sa ishte shuma e përafërt e të hollave të cilat mund të ishin në sef, për ditën dhe kohën kur duhet të vidhet sefi, për hyrjen kah mund të hyhet pa u vërejt, takimi te rrethi i spitalit e pastaj me qëllim që të sigurohet se në objekt nuk kishte mbetur askush e kishte thirrë menaxherin e objektit që ti sjell portofolin të cilin e kishte lënë me qëllim në objekt e pasi që ishte siguruar se në ato lokale nuk ishte askush, kishte informuar të dënuarit L.B dhe L.S të cilët pastaj kishin shkuar në objekt. Kur kësaj i shtohet fakti se i dënuari Sh.C ishte person i cili kishte punuar si kamarier në kafiterinë “D..C...” që gjendet në Qendrën Tregtare “A..M.” në P. dhe përmes kësaj kishte njohurit e theksuara, nga kjo del se në këtë rast kontributi i tij ishte mjaft i madh në planifikimin dhe kryerjen e veprës penale. Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të saj në faqen 24, duke u bazuar në veprimet e të dënuarit Sh.C para ngjarjes në dhënien e instruksioneve dhe po ashtu gjatë zhvillimit të ngjarjes duke i shoqëruar të dënuarit L.B dhe L.S deri në një distancë të caktuar dhe pastaj duke i prituri deri sa të kthehen dhe njëkohësisht duke qenë në dijeni se posedonin një armë me vete, vërteton pjesëmarrjen aktive të tij dhe kontributin thelbësor në kryerjen e kësaj vepre penale në realizimin e planit të përbashkët.

Kontributi i të dënuarit është tërësisht në harmoni me bashkëkryerjen siç përcaktohet me dispozitën e nenit 31 të KPRK-së *“Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për veprën penale.”*, ashtu që sipas këtij përkufizimi për të qenë bashkëkryerës në një vepre penale nuk është e domosdoshme prania fizike e të dënuarit siç pretendohet, mirëpo mjafton që thelbësisht të jepet kontributi edhe në ndonjë mënyrë tjetër në kryerjen e veprës penale. Në rastin konkret rezulton të mos jetë kontestues fakti se i dënuari Sh.C ishte duke punuar si kamarier në kafiterinë “D..C..”, kishte njohuri për sefin me para, se paratë e sefit nuk dërgoheshin ditëve të shtuna dhe të diela në bankë e për më tepër kishte njohuri për mundësinë më të lehtë të hyrjes në objekt nëpërmjet një hyrje të veçantë vetëm për stafin e kafiterisë, kurse këto njohuri nuk i kishin dy të dënuarit e tjerë, andaj në dritën e këtyre rrethanave të theksuara rezulton se veprimet e tij janë të natyrës thelbësore në kryerjen e veprës penale. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë thekson në faqen 25 të arsyetimit të saj se veprimet e të dënuarit Sh.C nuk konsistojnë vetëm në

dhënien e këshillave apo udhëzimeve se si kryhet vepra penale, pasi që në rastin konkret i dënuari ishte iniciuesi përkatësisht frymëzuesi i idesë për të hyrë për të vjedhur në lokalitetin ku ka punuar dhe ka marrë pjesë në planin e përgatitur për mënyrën e kryerjes, kohën kur do të kryhej vjedhja e pastaj dërgimi i të dënuarve deri te “B...A...” dhe pritja pas kryerjes së vjedhjes.

Pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i bazuar në prova të papranueshme pasi që bazohet në mbrojtjen e të dënuarve të tjerë dhe mbrojtjen vet akuzuese të të dënuarit Sh.C, po ashtu nuk është i bazuar pasi që bazuar në faqen e nëntë të arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë del se në shqyrtim gjyqësor janë administruar prova të shumta materiale dhe mes tyre edhe mbrojtja e të dënuarve, ashtu që mbrojtja e të dënuarve nuk paraqet provë të vetme në këtë çështje penale, sepse ka pasur edhe prova të tjera përmes të cilave është vërtetuar pa dyshim implikimi i të dënuarve në kryerjen e kësaj vepre penale.

Sa i përket pretendimeve përkitazi me shkeljen e ligjit penal përkatësisht dënimin e lartë të shqiptuar, gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar ligjin penal dhe të dënuarit i ka shqiptuar dënimin e përcaktuar brenda kornizave të minimumit dhe maksimumit të dënimit të përcaktuar dhe atë duke u bazuar në mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së kësaj vepre penale dhe ka çmuar të gjitha rrethanat përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit, për çka ka dhënë arsye ligjore.

Gjykata Supreme e Kosovës, konstatojë se konform dispozitës se nenit 385 par.5 të KPPK, kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet kur në marrjen e vendimit për dënim, dënimi alternativ, vërejtja gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore, që në rastin konkret nuk ka ndodhur.

Nuk janë të bazuara pretendimet e paraqitura në kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit L.B, av. R.K, se aktgjykimi i shkallës së parë dhe aktgjykimi i shkallës së dytë, janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e saj ka dhënë arsyetim të kuptueshëm dhe të qartë dhe nuk ka kundërthënie për faktet vendimtare, pasi që është përpiluar sipas dispozitës së nenit 370 të KPPK-së. Dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë përkitazi me të dënuarin L.B është i qartë dhe i kuptueshëm dhe nuk ka kundërthënie në brendinë e tij, pasi që janë përshkruar të gjitha veprimet konkrete të të dënuarit e

që në zingjirin e ngjarjes përmbajnë aspekte të bashkëkryerjes në veprën penale të vjedhjes grabitqare nga neni 328 par.4 të KPRK-së. Në dispozitiv të aktgjykimit janë shënuar në mënyrë konkrete veprimet e të dënuarit L.B, ashtu që me të dënuarin tjetër L.S shkojnë tek hyrja e ndërtesës së Qendrës tregtare “Albi Mall”, hyjnë në objekt të maskuar me kapela, shalla dhe dorëza, ngjiten në katin e tretë në drejtim të kafiterisë “D..C...”, hyjnë në lokal menjëherë, e marrin sefin dhe pasi që kanë marrë sefin kanë vërejte se tani i ndjeri N.R, është ofruar afër kafiterisë, i pandehuri L., me qëllim që ta mbaj pasurinë e vjedhur menjëherë me armë të tipit “E.. S..” 99 e kalibrit 7.65 mm. me nr.serik EV-... fillimisht ka shtënë një herë në drejtim të të ndjerit e pastaj kanë filluar të përleshën fizikisht e pastaj ka shtënë edhe tri herë tjera në të ndjerin. Nga përshkrimi i cituar del se në dispozitiv të aktgjykimit janë përshkruar edhe veprimet e të dënuarit L.B, e për më tepër edhe në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë duke u bazuar në mbrojtjen e të dënuarit del se arma-revolja të cilën e ka përdorur i dënuari L.S, ka qenë pikërisht e të dënuarit L.B.

Në rastin konkret nuk del të jetë kontestues fakti se paraprakisht tre të dënuarit kishin një plan për vjedhje të kasafortës në kafiterinë “D...C...” dhe se qëllimi i tyre ishte vjedhja e saj dhe ndarja e parave, por vet fakti se me vete kishin një revole dhe atë sipas mbrojtjes së vet të dënuarit L.B e kishte me vehte deri në vendin e quajtur “ Te B...A...” dhe pikërisht aty pas pengesave në bartjen e saj ia jep që ta bartë i dënuari tjetër L.S. Për më tepër i dënuari L.B, kishte njohuri se revolja kishte në karikator fishekë që tregon për qëllimin e tyre që të e përdorin, siç edhe ka ndodhur në rastin konkret.

Duhet theksuar se për tu përmbushur elementet e bashkëkryerjes së veprës penale nuk është e domosdoshme dhe e nevojshme që të dy bashkëkryerësit, në këtë rast të dënuarit L.B dhe L.S, të shkrepin me armë në drejtim të tani të ndjerit meqë kjo edhe fizikisht është e pamundur, por përcaktues janë edhe aspektet tjera të theksuara në faqen 25 të arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë ku theksohet se i dënuari L.B në momentin e të shtënës me armë ka qenë prezent e po ashtu edhe gjatë tërë aktit të kryerjes së vjedhjes. Për më tepër ishte prezent dhe pjesëmarrës në gjithë aktin e planifikimit të vjedhjes, ashtu që këto të dhëna padyshim se vërtetojnë në tërësi kontributin thelbësor të tij në kryerjen e veprës penale që është i nevojshëm sipas dispozitës së nenit 31 të KPRK-së për tu cilësuar si bashkëkryerje.

Pretendimet se gjykata e shkallës së dytë vetëm ka përshkruar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, po ashtu nuk është i bazuar pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë përmban arsye për të gjitha pretendimet ankimore të mbrojtësve të të dënuarve dhe ka konstatuar se nuk ka gjetur shkelje të pretenduara, ashtu që të gjeturat e kësaj gjykate i pranon në tërësi edhe Gjykata Supreme e Kosovës.

Përkitazi me pretendimet e paraqitura në kërkesë nga ana e mbrojtësit të të dënuarit L.S, av. N.H, po ashtu edhe këto pretendime nuk janë të bazuara se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje të dispozitave të procedurës penale. Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson përkatësisht numëron numër të madh të dispozitave të procedurës penale që janë shkelur nga ana e gjykatës së shkallës së dytë, mirëpo përveç shënimit të dispozitave ligjore nuk thekson konkretisht se ku konsistojnë shkeljet e theksuara.

Në këtë çështje penale rezulton të mos jetë kontestues fakti se të dënuarit në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qenë nën moshën 21 vjeçare, mirëpo megjithatë nuk është i bazuar pretendimi se gjykata e shkallës së parë ka refuzuar kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit L.S që çështja të procedohet nga departamenti për të mitur, pasi që sipas parashtrësive të datave 27.05.2015 dhe 22.04.2016, nuk ka pasur propozim që çështja të procedohet në departamentin për të mitur. Në parashtrësit e theksuara shqetësimet e mbrojtësit të të dënuarit janë shfaqur përkitazi me gjendjen e rënduar shëndetësore të të dënuarit L.S dhe nevojën e trajtimit të tij nga ana e mjekëve specialist të psikiatrisë me qëllim të tejkalimit të gjendjes së tij të rënduar shëndetësore dhe jo për faktin që çështja të gjykohet nga departamenti për të mitur.

Kurse pretendimi për ndryshimin e departamentit nga ai për krime të rënda në departamentin për të mitur për procedimin e kësaj çështje penale, theksohet në ankesën e paraqitur kundër aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë, me ç'rast, gjykata e shkallës së dytë në faqen e katërt të arsyetimit të aktgjykimin të saj ka theksuar se zbatimi i Kodit të Drejtësisë për të Mitur është çështje diskrecionale e gjykatës së shkallës së parë dhe jo detyrim i saj, pasi që në parim aplikohen dispozitat e KPPK-së, kurse përjashtimisht dispozitat e KDM-së.

Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme në faqen e 12 të aktgjykimin të saj përkitazi me provën e evidentuar me shifrën V#5, përkatësisht thikën e gjetur në vendin e ngjarjes

dhe e gjetur në afërsi të tani të ndjerit, mirëpo bazuar në raportin e ekspertizës së datës 20.04.2015 nga ana e Agjencionit për Forenzikë, konstatohet se dëshmia V#5 (një thikë me ngjyrë të zezë me mbishkrimin USA SABER nga vendi i ngjarjes) është fituar nga një profil i njëjtë i ADN-së nga një person i panjohur i gjinisë mashkullore, ashtu që nuk është vërtetuar siç pretendohet në kërkesë se thika ka qenë në posedim të tani të ndjerit. Sa i përket kësaj çështje duhet theksuar se kjo është trajtuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë me rastin e vendosjes përkitazi me kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit për hudhje të aktakuzës dhe me këtë rast pretendimet e theksuara janë hudhur si të pabazuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

Sa i përket refuzimit të propozimit për dëgjimin e ekspertit të mjekësisë ligjore Dr. F.D, përkitazi me lëndimet trupore të pësuara nga ana e të dënuarit L.S, gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të saj në faqen 24, ka dhënë arsye përkitazi me refuzimin e dëgjimit të ekspertit pasi që propozimi nuk ka qenë i shoqëruar me arsyetime se në cilat rrethana do të vërtetoheshin me rastin e dëgjimit të tij.

Pretendimi del të jetë i pabazuar edhe përkitazi me theksimet se në rastin konkret si rezultat i shkeljeve procedurale, ka pasuar edhe kualifikimin jo i drejtë të veprës penale, pasi që qëllimi i të dënuarit nuk ka qenë kryerja e veprës penale vjedhja grabitqare nga neni 328 par.4 i KPRK-së, pasi që privimi nga jeta i të dëmtuarit ka ardhur si rezultat i reagimit të të dëmtuarit dhe për më tepër nuk është vërtetuar se me të shtënë e parë është goditur i dëmtuari, përkatësisht plagët i ka marrë pas konfliktit fizik mes tyre. Megjithatë në faqen 26 të arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është theksuar se pretendimi se i dënuari ka shtënë në të ndjerin pasi që fillimisht ka qenë i sulmuar, është i pabazuar pasi që siç vërtetohet nga video incizimet e administruara në cilësinë e provës, i dënuari L1. ka filluar të shtënë në tani të ndjerin N. në një distancë e cila nuk ka paraqit rrezik për jetën e tij e për më tepër, tani i akuzuari L1. nuk ka qenë fare i sulmuar.

Edhe pse kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, janë paraqitur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, megjithatë bazuar në përmbajtjen e tyre, janë paraqitur pretendime për konstatimin e gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mirëpo, këto pretendime nuk janë vlerësuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, meqë bazuar në dispozitën e nenit 432 par.2 të KPPK-së, meqë kërkesa për mbrojtjen e

ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 dhe 438 par. 1 nënpar.1.2 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.324/2018, më 18 dhjetor 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka